



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1946/1 prot.

Tiranë, më 17.05.2024

Lënda: Dërgohen listat dhe raporti për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT**

Në vëmendje të: Znj. Klotilda BUSHKA

Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

E nderuar znj. Kryetare,

Të nderuar anëtarë,

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përfundoi procesin e verifikimit të kushteve dhe vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve.

Në zbatim të nenit 35, pika 7, të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm ka hartuar:

- listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- listën me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- raportin me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni Ad Hoc.

Në respekt të përcaktimit ligjor të nenit 35, pika 9, të ligjit nr. 115/2016, listat dhe raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit janë bërë publike menjëherë në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbështetje të nenit të lartpërmendur, Sekretari i Përgjithshëm i përcjell Komisionit të përhershëm përgjegjës për Çështjet Ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit të dokumenteve, listat së bashku me raportin përkatës dhe dokumentacionin për secilin kandidat, për të vijuar me procedurat e mëtejshme të parashikuara nga ligji nr.115/2016.

Ju bëjmë me dije se dosjet me dokumentacionin për secilin kandidat përcillen të fotokopjuara, ndërkohë që dosjet origjinale janë të administruara në zyrën e Protokollit të Kuvendit.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga trupa e avokatëve, që plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga neni 147 i Kushtetutës dhe neni 19, pika 3, i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “a”, të ligjit të lartpërmendur:

- 1. Eris Hysi**
- 2. Erind Mërkuri**
- 3. Erind Gërmenji**
- 4. Albens Tabaku**
- 5. Klodian Gjermani**
- 6. Artan Reçi**
- 7. Bledar Bajri**
- 8. Saimir Kola**

Lista e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, që nuk plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 19, pika 3, i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, sipas vlerësimit të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 35, pika 7, shkronja “b”, të ligjit nr. 115/2016:

(Sipas rendit alfabetik të emrit)

1. Kandidati Alban Alimema

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, konkretisht, vërtetimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe verifikimi i kryer, gjithashtu, dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës dërguar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezulton se kandidati ka ndërprerje të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për një periudhë totale prej 14 muajsh (korrik-tetor 2019, prill-tetor 2020, dhjetor 2020-shkurt 2021).

Sa më lart, kandidati nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Alban Alimema nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

2. Kandidatja Albana Tushe

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore përmes vërtetimit për bazën e vlerësuar, nga verifikimi i kryer rezulton se kandidatja ka ndërprerje të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për një periudhë totale prej 7 muajsh.

Nga sa më lart, kandidatja nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidatja rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara mbi plotësimin e DIVA-s dhe nuk ka dorëzuar deklaratën e tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin 2018.

Nga sa më lart, rezulton se kandidatja nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë shlyer rregullisht detyrimet tatimore dhe financiare.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, kandidatja Albana Tushe nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

3. Kandidatja Entela Shehu Memishaj

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates ka rezultuar se mungonin dokumentet që provonin përmbushjen e kushtit të përcaktuar në nenit 19, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr.115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist.

Sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm bëri njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë në adresën elektronike të deklaruar nga kandidati.

Kandidatja, brenda afatit të përcaktuar, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të provuar përmbushjen e këtij kushti ligjor.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidatja rezulton se nuk ka plotësuar DIVA-n për vitet 2012, 2013, 2014.

Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, dhe nga përgjigjet e administruara nga organet ligjzbatuese në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidatja Entela Shehu Memishaj nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

4. Kandidati Fatos Lazimi

Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kandidati Fatos Lazimi, nga muaji qershori i vitit 2022 e në vijim rezulton i punësuar si këshilltar juridik pranë Autoritetit Hekurudhor.

Referuar pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: “Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, nuk mund të kryejë njëkohësisht detyrën e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbaruesit gjyqësor, si dhe asnjë funksion

apo detyrë tjetër në organet publike, me përjashtim të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit.”

Sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit nr. 89/2021 “Për krijimin e autoritetit rregullator hekurudhor”: “Marrëdhëniet e punës së drejtorit ekzekutiv dhe të nëpunësve të administratës së Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.”

Bazuar në sa më lart kandidati ushtron profesionin e avokatit në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Në këto kushte kandidati nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, kandidati Fatos Lazimi nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

5. Kandidati Përparim Kalo

Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kandidati ka qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga periudha 24 dhjetor 2020 deri më 3 qershor 2022 (1 vit e 6 muaj), periudhë kjo që ndërpret angazhimin e tij pa ndërprerje si avokat 10 vitet e fundit, kusht i përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidati rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara (*penalitet për mospagesë në kohë të detyrimit për këstet e tatimfitimit*).

Nga sa më lart rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 19, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë shlyer rregullisht detyrimet tatimore dhe financiare.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Përparim Kalo nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

6. Kandidati Saimir Vishaj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, dhe përgjigjet e administruara nga organet ligjzbatuese në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Saimir Vishaj nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

**RAPORT PËR PROCESIN E VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM TË
PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE DHE KRITEREVE PROFESIONALE E
MORALE PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR NGA
RADHËT E AVOKATËVE**

I. Hyrje

Në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe në zbatim të detyrimeve që më ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me vendimin nr. 3, datë 19.07.2023, në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 115/2016 kam vendosur shpalljen e vendeve vakante për 2 pozicione pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve.

Pas ndjekjes së procedurës së verifikimit paraprak nga Komisioni Ad Hoc dhe marrjes në dorëzim të vlerësimit nga ana e tyre, sipas përcaktimeve ligjore kam vijuar menjëherë me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve të cilët janë kualifikuar.

Procedura e ndjekur paraqitet hollësisht si vijon:

II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROCESIT TË VLERËSIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 147 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në procesin e verifikimit të kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Referuar këtij neni:

“5. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kandidaturave, verifikon nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, si dhe vlerëson kriteret profesionale e morale për anëtarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përgatit listën. Në rast se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret për t’u zgjedhur, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nuk i përfshin emrat e tyre në listë.

6. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas përfundimit të verifikimeve, i dërgon menjëherë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale nënkomisionit, sipas paragrafit 7 të këtij neni.”

Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm në këtë proces, gjithashtu, janë detajuar në nenin 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në nenin 35 të këtij ligji, ndër të tjera parashikohet se:

1. Kryetari i Komisionit të Pavarur Ad Hoc (sipas përcaktimeve në nenit 23 të ligjit nr. 115/2016 është Avokati i Popullit) i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante. Lista me emrat e renditur të kandidatëve dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe raporti i vlerësimit regjistrohën në regjistrin e protokollit të Kuvendit të Shqipërisë. Asaj i bashkëngjiten kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së listës dhe dokumentacionit shoqërues, të regjistruar sipas pikës 1, të këtij neni, verifikon, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, nëse kandidatët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe neni 19 i këtij ligji. Sekretari i Përgjithshëm përjashton kandidatët, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj.
3. Nëse dokumentacioni i kandidatit nuk është i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kriterëve profesionale e morale, sipas nenit 19, pika 3, të këtij ligji, Sekretari i Përgjithshëm i kërkon kandidatit që brenda 5 ditëve të bëjë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i dërgohet kandidatit në adresën elektronike të deklaruar.
4. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk pezullon procesin e regjistrimit përfundimtar në Kuvend të listës së kandidatëve dhe dokumentacionit shoqërues të saj.
5. Data në të cilën plotësohet dokumentacioni i kërkuar, ose afati i përcaktuar për plotësimin, konsiderohet dhe dita e paraqitjes dhe regjistrimit të listës së kandidatëve të dhe dokumentacionit shoqërues në Kuvend. Paraqitja përfundimtare dokumentohet me një numër regjistrimi nga zyra e protokollit në Kuvend.
6. Sekretari i Përgjithshëm vlerëson kriteret profesionale e morale vetëm për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Vlerësimi i kriterëve profesionale e morale të kandidatëve nga Sekretari i Përgjithshëm bëhet sipas kriterëve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji.

7. Sekretari i Përgjithshëm, në përfundim të procedurës së parashikuar në pikat 2 dhe 6, të këtij neni, harton dokumentet e mëposhtme:

- a) një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) një listë me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe arsyet e përjashtimit për secilin;
- c) një raport me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kritereve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe raportin e përgatitur nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc.

8. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, në mënyrë individuale dhe të arsyetuar për përjashtimin në adresën e tyre elektronike të deklaruar.

9. Sekretari i Përgjithshëm i dërgon komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit të dokumenteve të parashikuara në pikën 7, të këtij neni, listat, së bashku me raportin e parashikuar në pikën 7, shkronja “c”, të këtij neni, si dhe dokumentacionin për secilin kandidat. Listat dhe raporti bëhen publikë në faqen zyrtare të Kuvendit jo më vonë se 10 ditë pas regjistrimit të listës së kandidatëve në Kuvend.

10. Në zbatimin e detyrave të parashikuara në pikat 1 deri në 6, të këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga shërbimet e Kuvendit.

Vlerësimi dhe verifikimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit fillon menjëherë pas depozitimit në Kuvend të dokumentacionit dhe të listës së kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga Avokatia, nga Kryetari i Komisionit të Pavarur Ad Hoc.

III. PROCESI I VERIFIKIMIT NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM TË PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE SIPAS NENIT 19 TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

A. Procesi i aplikimit të kandidatëve për anëtarë të KLGJ-së nga Avokatia

Sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr. 115/2016, jo më vonë se 4 muaj para datës së mbarimit të mandatit të anëtarëve avokatë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në detyrë, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit shpall vendet vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga avokatët që plotësojnë kriteret e parashikuara nga ligji i lartpërmendur.

Në zbatim të kësaj dispozite, me vendimin nr. 3, datë 19.07.2023, Sekretari i Përgjithshëm shpalli në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë vendet vakante për dy anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Avokatia.

Në vijim të kësaj shpalljeje, institucionet e ngarkuara nga ligji, vijuan me procedurat përkatëse të përcaktuara në nenet 21-35 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.5, datë 20.12.2018, konsoliduar me vendimin nr. 448, datë 15.10.2020, përfundonte në datën 12.12.2023.

B. Procedura e ndjekur nga Sekretari i Përgjithshëm pas paraqitjes së dosjeve të kandidatëve për KLGJ nga Avokatia, nga Komisioni Ad Hoc i verifikimit dhe vlerësimit paraprak të kandidatëve.

Bazuar në pikën 5 të nenit 31 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit, nëpërmjet shkresës nr. 3816, datë 12.12.2023, ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë për publikim në faqen zyrtare njoftimin publik në lidhje me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Avokati i Popullit, me shkresën nr. 294 prot., datë 24.01.2024, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, të ngritur për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë, listën e 13 kandidatëve që përmbushin kriteret ligjore sipas vlerësimit të Komisionit dhe që kanë marrë pikët më të larta, si dhe listën e 15 kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe raportin e vlerësimit të kandidatëve.

Dokumentacioni i përcjellë nga Komisioni Ad Hoc është paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë me vonesa të theksuara në raport me përcaktimet ligjore. Sipas përlogaritjes së afateve të vendosura në ligjin nr. 115/2016, dokumentacioni duhet të ishte paraqitur në fund të muajit tetor 2023.

Gjithashtu, për çdo kandidat është përcjellë dokumentacioni përkatës mbi të cilin Komisioni ka kryer verifikimin paraprak dhe vlerësimin me pikë.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas depozitimit të listës së kandidatëve nga Avokatia për anëtarë të KLGJ-së dhe dosjeve përkatëse, ka filluar menjëherë punën për verifikimin e

plotësimin të kushteve ligjore të kandidatëve bazuar në parashikimet e Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Sipas përcaktimeve të nenit të lartpërmendur, kushtet ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët e propozuar nga trupa e avokatisë janë:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit dhe të kenë marrë një diplomë të njësuar, sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- c) të jenë avokatë të licencuar sipas ligjit;
- ç) të kenë shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore dhe financiare ndaj Dhomës së Avokatisë;
- d) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si juristë, nga të cilat të paktën 10 vitet e fundit të kenë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje;
- dh) të jenë licencuar për të ushtruar profesionin pranë Gjykatës së Lartë dhe/ose Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit “Për profesionin e avokatit”;
- e) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- ë) të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) të mos kenë mbajtur gjatë 10 viteve të fundit funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në partitë politike;
- g) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- gj) të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës;
- h) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe të afërm të shkallës së parë që është anëtar në detyrë i Këshillit ose kandidat për anëtar;
- i) të mos jenë larguar nga detyra të mëparshme si gjyqtar, prokuror ose oficer i Policisë Gjyqësore me masë disiplinore;
- j) të mos jenë kandidatë të propozuar nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si dhe nga shoqëria civile.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ushtrimit të kompetencave të tij, si dhe me qëllim vlerësimin sa më korrekt dhe të mbështetur në evidenca zyrtare nga institucionet përgjegjëse dhe ligjzbatuese, parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, gjatë fazës së verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar nga Avokatia, ka kërkuar

kryerjen e verifikimeve përkatëse për 14 (katërmëdhjetë) kandidaturat që kanë aplikuar për Këshillin e Lartë Gjyqësor, nga këto institucione:

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- Shërbimi Informativ Shtetëror
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
- Prokuroria e Përgjithshme
- Prokuroritë e rretheve
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave

Në vijim të procesit të sipërcituar, Sekretari i Përgjithshëm, nëpërmjet vendimit nr. 392, datë 01.02.2024, vendosi: “Pezullimin e afatit të parashikuar në nenet 147 dhe 149, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 35, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, deri në disponimin e përgjigjeve përkatëse nga institucionet e lartpërmendura”.

Me shkresën nr. 294/3 prot., datë 02.05.2024, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Ad Hoc, ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë raportin shtesë të vlerësimit dhe dokumentacionit përkatës të kandidatit Saimir Kola për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, në zbatim të vendimit nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në pikat 1 dhe 7 të nenit 9, të “Rregullores për funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve”¹.

Në vijim të kërkesës për informacion, të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, me nr. 440 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1702 prot., datë 02.05.2024, nëpërmjet shkresës nr.440/1, datë 16.02.2024, dhe nr. 1702/1, datë 09.05.2024, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, shprehet se vetëm tre nga kandidatët për anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së nga Avokatia, kanë qenë subjekte deklaruese pranë ILDKPKI-së.

Për të verifikuar integritetin e kandidatëve, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 437 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1699 prot., datë 02.05.2024, duke i përcjellë formularët e deklarimit të plotësuar nga secili nga shtatë kandidatët, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, dhe ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, për të kthyer përgjigjen në respektim të afateve ligjore.

¹ Sqarimi në lidhje me procedurën e ndjekur për kandidatin Saimir Kola është dhënë në Aneksin 1, bashkëlidhur raportit.

Nëpërmjet shkresave nr. 437/1 prot., datë 09.02.2024, nr. 437/2 prot., datë 21.03.2024, nr. 437/3 prot., datë 21.03.2024, nr. 437/4 prot., datë 21.03.2024, nr. 437/5 prot., datë 25.03.2024, nr. 437/6 prot., datë 26.03.2024, nr. 437/7 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/1 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/2 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/3 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/4 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/5 prot., datë 26.03.2024, nr. 1118/6 prot., datë 26.03.2024, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë vendimet për mospranim të kërkesës për verifikim paraprak për kandidaturat, ndërsa me shkresën nr. 1699/1 prot., datë 08.05.2024, ka përcjellë shkresën për plotësim të të metave lidhur me kriteret formale ligjore të kërkesës.

Për të verifikuar integritetin e kandidaturave, Sekretari i Përgjithshëm u është drejtuar me shkresën nr.438 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1701 prot., datë 02.05.2024, prokurorive të rretheve: Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, duke kërkuar nëse për kandidatët e përcjellë janë regjistruar kallëzime/ referime, janë regjistruar procedime penale, nëse kanë qenë ose janë persona në hetim, përfshirë vendimmarrjen e prokurorisë lidhur me hetimet, janë hetuar me masë sigurimi, përfshirë kopjen e vendimmarrjes së gjykatës për caktim mase, janë hetuar me vendim penal jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale, si dhe përditësim për statusin aktual të hetimit, nëse janë në hetim. Me shkresat nr. 438/13 prot., datë 04.03.2024, nr. 438/15 prot., datë 20.03.2024, nr. 438/3 prot., datë 12.02.2024, nr. 438/2 prot., datë 12.03.2024, nr. 438/14 prot., datë 04.03.2024, nr. 438/4 prot., datë 12.02.2024, nr. 438/1 prot., datë 12.02.2024, nr. 438/15 prot., datë 20.03.2024, nr. 438/8 prot., datë 15.02.2024, nr. 438/10 prot., datë 16.02.2024, nr. 438/7 prot., datë 20.03.2024, nr. 438/6 prot., datë 20.03.2024, nr. 438/5 prot., datë 14.02.2024, nr. 1701/1, datë 09.05.2024, nr. 1701/2, datë 09.05.2024, nr. 1701/3, datë 10.05.2024, nr. 1701/4, datë 10.05.2024, nr. 1701/5, datë 10.05.2024, nr. 1701/6, datë 10.05.2024, nr. 1701/7, datë 13.05.2024, nr. 1701/8, datë 13.05.2024, nr. 1701/9, datë 13.05.2024, nr. 1701/10, datë 13.05.2024, nr. 1701/11, datë 16.05.2024, nr. 1701/12, datë 16.05.2024 dhe nr. 1701/13, datë 16.05.2024 janë kthyer përgjigjet përkatëse.

Për të verifikuar gjendjen gjyqësore të kandidatëve të cilët në dosjet personale kishin depozituar vetëm formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr. 439 prot., datë 06.02.2024, dhe nr.1705 prot., datë 02.05.2024, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr.439/1 prot., datë 12.02.2024 dhe nr.1705/1 prot., datë 16.05.2024, konfirmon se kandidatët rezultojnë të padënuar.

Për të vërtetuar vjetërsinë në punë, sipas përcaktimeve ligjore, jo më pak se 15 vite pune në profesion si jurist, Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr.444 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1707 prot., datë 02.05.2024, i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore për informacion në lidhje me pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga kandidatët. Me shkresën nr. 444/1 prot., datë 14.02.2024, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka paraqitur të dhëna rreth kandidatëve nga viti 2012 deri në dhjetor 2023, për arsye se sistemi informatik i ISSH-së nuk ka të regjistruara të dhëna para këtij viti. Ndërkohë, Drejtori i ISSH-së, me shkresën nr.444/2 prot., datë 14.02.2024, dhe nr. 1706/2, datë 13.05.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër mbi të dhënat e kërkuara për periudhën para vitit 2012 për kandidatët dhe vënien në dispozicion të këtij informacioni Kuvendit të Shqipërisë. Me shkresën nr.444/3 prot., datë 19.02.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ka kërkuar të dhëna shtesë për çdo kandidat në lidhje me punësimet e mëparshme.

Me shkresën nr.444/4 prot., datë 28.02.2024, dhe nr. 1706 prot., datë 02.05.2024, i janë dërguar institucionit të dhënat e kërkuara. Me shkresën nr.1018 prot., datë 19.03.2024, nr. 1706/1 prot., datë 10.05. 2024, nr. 1706/2 prot., datë 13.05. 2024, nr. 1706/3 prot., datë 16.05. 2024, dhe Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë shkresën me të dhëna të kandidatëve, të dhëna të cilat nuk përmbushnin në mënyrë shteruese kërkesat e Kuvendit të Shqipërisë, për shkak të vështirësive në identifikimin e pozicionit të punës të kandidatëve.

Për të verifikuar përcaktimet e shkronjës “ç”, pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, Kuvendi i Shqipërisë, me shkresat nr.441 prot., datë 06.02.2024, nr.441/2 prot., datë 20.03.2024, dhe nr. 1704 prot., datë 02.05.2024, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëse kandidatët kanë shlyer rregullisht detyrimet tatimore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresat nr.441/1 prot., datë 29.02.2024, nr.441/3 prot., datë 20.03.2024, dhe nr. 1712/1, datë 10.05.2024, ka kthyer përgjigje mbi detyrimet tatimore si individë të regjistruar në përgjegjësinë tatimore DIVA dhe detyrimet tatimore si subjekte tatimpaguese.

Për të verifikuar përcaktimet e pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr.442 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1700 prot., datë 02.05.2024, i ka kërkuar Shërbimit Informativ Shtetëror verifikimin e kandidaturave. Nga Shërbimi Informativ Shtetëror është përcjellë informacioni i klasifikuar.

Njohja me informacionin e klasifikuar do të zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

Për të verifikuar përcaktimet e pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm, me shkresën nr. 443 prot., datë 06.02.2024, dhe nr. 1703 prot., datë 02.05.2024, i ka kërkuar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, verifikimin për këta kandidatë. Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me shkresat nr.443/1 prot., nr.443/2 prot., nr.443/3 prot., nr.443/4 prot., nr.843 prot., nr.843/1 prot., nr.843/2 prot., nr. 843/3 prot., nr.843/4 prot., nr.843/5 prot., nr.843/6 prot., nr.843/6 prot., nr.843/7 prot., datë 04.03.2024, ka sqaruar se për 12 kandidatë, në përfundim të procedurave të verifikimit, autoritetet verifikuese na informojnë se nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e tyre në veprimtari që cenojnë sigurinë apo në aktivitete të kundërligjshme. Nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar është përcjellë informacion i klasifikuar. Njohja me informacionin e klasifikuar do të zhvillohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

Pas administrimit të përgjigjeve të cituara më lart nga institucionet, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, me vendimin nr.3, datë 29.03.2024, ka shfuqizuar vendimin e pezullimit nr. 392, datë 01.02.2024.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara për Sekretarin e Përgjithshëm (pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 35 të ligjit të sipërcituar), ky i fundit gjatë verifikimit ka konstatuar se disa kandidatë, të cilët sipas Komisionit Ad Hoc të verifikimit pranë Avokatit të Popullit janë vlerësuar se plotësojnë kushtet kushtetuese dhe ligjore, kishin mangësi në dokumentacionin ligjor për të provuar plotësimin e këtyre kushteve.

Për sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në parashikimet e pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, u ka komunikuar këtyre kandidatëve në datën 2 prill 2024, përmes postës elektronike personale të deklaruar në momentin dhe në dokumentacionin e aplikimit, mangësitë që kanë në dosje, duke vendosur një afat 5-ditor, në përputhje me afatin ligjor (brenda datës 9 prill 2024) për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar. Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të integritetit të kandidatëve, referuar përcaktimeve të pikave 3 dhe 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në vijim të një praktike të konsoliduar në procedurat e mëparshme përzgjedhëse, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit u ka kërkuar kandidatëve dorëzimin e deklaratës së interesave privatë.

Ndërkohë, disa kandidatë kërkuan shtyrjen e afatit për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar, dhe në këto kushte Sekretari i Përgjithshëm vendosi të shtyjë afatin e dorëzimit deri në datën 12.04.2024.

IV. VERIFIKIMI I PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE NGA KANDIDATËT

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 35 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, siç u parashtrua më lart:

- ka verifikuar nëse dokumentacioni i kandidatëve është i plotë, duke kërkuar nga kandidatët plotësimet përkatëse;
- ka verifikuar dhe vlerësuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 147, pika 5, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 19, pika 3, i ligjit nr.115/2016, si dhe të dokumentacionit që shoqëron shprehjen e interesit, të parashikuar në pikën 3 të nenit 21 të po këtij ligji;
- ka verifikuar dhe vlerësuar kushtin ligjor të përvojës profesionale si jurist për jo më pak se 15 vjet, duke mbajtur parasysh dispozitën ligjore.

Pas njoftimit për plotësimin e dokumentacionit apo paraqitjen e dokumentacionit shtesë, në adresën elektronike të deklaruar nga kandidatët, si dhe pas përgjigjeve zyrtare të administruara nga institucionet publike, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit konstaton si vijon:

A. KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

Plotësimi i dokumentacionit si dhe verifikimi dhe vlerësimi i plotësimin të kushteve ligjore për çdo kandidat është si më poshtë:

1. Kandidati Albens Tabaku

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte një dokument që provon përmbushjen e kushtit të përcaktuar në nenin 19, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr.115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist.

Sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm bëri njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë në adresën elektronike të deklaruar nga kandidati.

Në dokumentacionin e depozituar në datën 08.04.2024 pranë Zyrës së Protokollit të Kuvendit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara (fotokopje e librezës së punës, fotokopje e librezës së pagesës së sigurimeve shoqërore) brenda afatit ligjor për plotësimin e dokumentacionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit

të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Albens Tabaku plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

2. Kandidati Artan Reçi

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte një dokument që provon përmbushjen e kushtit të përcaktuar në nenin 19, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr.115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist.

Sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm bëri njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë në adresën elektronike të deklaruar nga kandidati.

Në dokumentacionin e depozituar në datën 08.04.2024 pranë Zyrës së Protokollit të Kuvendit, kandidati ka paraqitur dokumentet e kërkuara (fotokopje e librezës së punës) brenda afatit ligjor për plotësimin e dokumentacionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 nenit të 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Artan Reçi plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

3. Kandidati Bledar Bajri

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit ka rezultuar se mungonte një dokument që provon përmbushjen e kushtit të përcaktuar në nenit 19, pika 3, shkronja “d”, të ligjit 115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist.

Sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm bëri njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë në adresën elektronike të deklaruar nga kandidati.

Në dokumentacionin e depozituar pranë Zyrës së Protokollit të Kuvendit, kandidati ka paraqitur dokumentet brenda afatit ligjor për plotësimin e dokumentacionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Bledar Bajri plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

4. Kandidati Erind Gërmenji

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Erind Gërmenji plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

5. Kandidati Erind Mërkuri

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Erind Mërkuri plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

6. Kandidatja Eris Hysi

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidatja Eris Hysi plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

7. Kandidati Klodian Gjermani

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Klodian Gjermani plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

8. Kandidati Saimir Kola

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Saimir Kola plotëson të gjitha kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

B. KANDIDATËT QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET LIGJORE

Nga dokumentacioni i paraqitur nga Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetares së Komisionit Ad Hoc, sipas verifikimit të kryer ka rezultuar se janë 15 kandidatë të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të KLGJ-së.

Ndërkohë, nga Kryetarja e Komisionit Ad Hoc është përcjellë me shkresën nr.294, datë 24.01.2024, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 35, edhe lista me kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore të përcaktuara në nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, si dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit nr. 115/2016.

Pas paraqitjes së dokumentacionit në Kuvendin e Shqipërisë, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë mori në shqyrtim, në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe pikës 2 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, kandidatët të cilët janë vlerësuar me pikë për kriteret profesionale dhe morale nga Komisioni Ad Hoc.

Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në pikën 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në pikën 7 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, ka verifikuar dokumentacionin individual në dosje të secilit kandidat të vlerësuar me pikë dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë:

1. Kandidati Alban Alimema

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, konkretisht, vërtetimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe verifikimi i kryer gjithashtu dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës dërguar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezulton se kandidati ka ndërprerje të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për një periudhë totale prej 14 muajsh (korrik-tetor 2019, prill-tetor 2020, dhjetor 2020-shkurt 2021).

Sa më lart, kandidati nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Alban Alimema nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

2. Kandidatja Albana Tushe

Nga dokumentacioni i përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore përmes vërtetimit për bazën e vlerësuar, nga verifikimi i kryer rezulton se kandidatja ka ndërprerje të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për një periudhë totale prej 7 muajsh.

Nga sa më lart, kandidatja nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidatja rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara mbi plotësimin e DIVA-s dhe nuk ka dorëzuar deklaratën e tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin 2018.

Nga sa më lart, rezulton se kandidatja nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë shlyer rregullisht detyrimet tatimore dhe financiare.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, kandidatja Albana Tushe nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

3. Kandidatja Entela Shehu Memishaj

Nga shqyrtimi i dosjes së kandidates ka rezultuar se mungonin dokumentet që provonin përmbushjen e kushtit të përcaktuar në nenin 19, pika 3, shkronja “d”, të ligjit nr.115/2016, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion si jurist.

Sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm bëri njoftimin për plotësimin e dokumentacionit dhe paraqitjen e dokumentacionit shtesë në adresën elektronike të deklaruar nga kandidati.

Kandidatja, brenda afatit të përcaktuar, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të provuar përmbushjen e këtij kushti ligjor.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidatja rezulton se nuk ka plotësuar DIVA-n për vitet 2012, 2013, 2014.

Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, dhe nga përgjigjet e administruara nga organet ligjzbatuese në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidatja Entela Shehu Memishaj nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

4. Kandidati Fatos Lazimi

Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kandidati Fatos Lazimi, nga muaji qershori i vitit 2022 e në vijim rezulton i punësuar si këshilltar juridik pranë Autoritetit Hekurudhor.

Referuar pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: “Avokati, gjatë ushtrimit të profesionit, nuk mund të kryejë njëkohësisht detyrën e gjyqtarit, prokurorit, noterit, përmbaruesit gjyqësor, si dhe asnjë funksion apo detyrë tjetër në organet publike, me përjashtim të mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit.”

Sipas përcaktimeve të nenit 15 të ligjit nr. 89/2021 “Për krijimin e autoritetit rregullator hekurudhor”: “Marrëdhëniet e punës së drejtorit ekzekutiv dhe të nëpunësve të administratës së Autoritetit rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.”

Bazuar në sa më lart, kandidati ushtron profesionin e avokatit në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

Si rezultat, kandidati nuk përmbush kushtin e vendosur në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016, ku përcaktohet se “...duhet të ketë ushtruar profesionin e avokatit pa ndërprerje të paktën 10 vitet e fundit”.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, kandidati Fatos Lazimi nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

5. Kandidati Përparim Kalo

Sipas dokumentacionit të përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kandidati ka qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese nga periudha 24 dhjetor 2020 deri më 3 qershor 2022 (1 vit e 6 muaj), periudhë kjo që ndërpret angazhimin e tij pa ndërprerje si avokat 10 vitet e fundit, kusht i përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016.

Gjithashtu, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kandidati rezulton se ka detyrime tatimore të papaguara (*penalitet për mospagesë në kohë të detyrimit për këstet e tatimit*).

Nga sa më lart, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e përcaktuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 19, ku përcaktohet se kandidati duhet të ketë shlyer rregullisht detyrimet tatimore dhe financiare.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mbështetje të pikës 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Përparim Kalo nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

6. Kandidati Saimir Vishaj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, dhe përgjigjet e administruara nga organet ligjzbatuese në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

dhe nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, rezulton se kandidati Saimir Vishaj nuk plotëson kushtet ligjore për t’u kualifikuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRMBUSHJES SË KRITEREVE PROFESIONALE DHE MORALE, SIPAS NENIT 34 TË LIGJIT NR. 115/2016, NGA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KUVENDIT

A. Verifikimi i kriterëve profesionale dhe morale, sipas nenit 34 të ligjit nr. 115/2016

Pas përfundimit të verifikimit mbi kushtet ligjore të kandidatëve (pikat 2-5 të nenit 35 të ligjit) Sekretari i Përgjithshëm vendosi për kualifikimin dhe vijimin e procedurës sipas ligjit, për 8 (tetë) kandidatë nga 14 (katërbëdhjetë) kandidatë që u përcollën në listën e depozituar nga Komisioni Ad Hoc.

Sekretari i Përgjithshëm, në respektim të pikës 6 të nenit 35, zhvilloi më tej procesin e vlerësimit të shkallës së përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale të parashikuara nga neni 34 i ligjit nr. 115/2016, për secilin nga kandidatët e kualifikuar që përmbushin kushtet ligjore.

Neni 34 i ligjit nr. 115/2016 parashikon në mënyrë të detajuar kriteret morale dhe profesionale mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi i kandidaturave për Këshillin e Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

Meritat profesionale

- a) rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon;
- b) vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës;
- c) rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë;
- ç) ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit.

Meritat morale

- a) reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve;
- b) cilësitë morale, të tilla si: ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij;

c) angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

- a) cilësitë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore;
- e) aftësitë e përfaqësimit në publik.

Kritere të përgjithshme

- a) mbajtja e titujve akademikë;
- b) kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit;
- c) njohja e gjuhëve të huaja.

B. Vlerësimi sipas Komisionit Ad Hoc

Në bazë të nenit 35, pika 7, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, në raportin për vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale, Sekretari i Përgjithshëm mbështetet në procesin e zhvilluar, në raportin si dhe në dokumentacionin e përcjellë nga Komisioni Ad Hoc. Në mbështetje të nenit 34 të ligjit nr. 115/2016, Komisioni Ad Hoc harton një raport vlerësimi të shkallës së përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve dhe bën renditjen e tyre.

Në shkresën nr. 294, datë 24.01.2024, Komisioni Ad Hoc ka paraqitur në mënyrë tabelore vlerësimin e kryer, që rezulton si më poshtë:

Nr.	Kandidati	Vlerësimi total
1.	Eris Hysi	93.8
2.	Përparim Kalo	89.8
3.	Erind Mërkuri	88.4
4.	Alban Alimema	86.5
5.	Erind Gërmenji	81.4
6.	Fatos Lazimi	81.2
7.	Entela Shehaj Memishaj	81
8.	Saimir Vishaj	76.2
9.	Albana Tushe	68
10.	Albens Tabaku	66.2
11.	Klodian Gjermani	64.3
12.	Artan Reçi	58.6
13.	Bledar Bajri	53.2
14.	Saimir Kola	33.8

VI. VLERËSIMI I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KUVENDIT

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit hartoi vendimin nr. 4, datë 12.04.2024, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale te kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga radhët e avokatëve”. Në vendim është konceptuar një ndarje prej katër nivele meritash, të ndara në komponentë referuar nenit 34 të ligjit, si më poshtë:

Meritat profesionale: 4 komponentë, që përfshijnë:

- rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse që lidhet me veprimtarinë e institucionit për të cilën kandidon (6 pikë);
- vlerësimin e rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, pjesëmarrjen në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës (6 pikë);
- rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë (6 pikë);
- ecurinë në punë dhe pjesëmarrjen në trajnimet profesionale dhe në kurse të tjera të certifikuara brenda dhe jashtë vendit (6 pikë).

Totali i pikëve për këtë komponent është 24 pikë.

Meritat morale: 3 komponentë, që përfshijnë:

- reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve (6 pikë);
- cilësitë morale, të tilla si: ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, etika profesionale, përdorimi i të gjitha mjeteve të ligjshme për mbrojtjen me besnikëri të të drejtave të personave që përfaqësohen prej tij (10 pikë);
- angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile (6 pikë).

Totali i pikëve për këtë komponent është 22 pikë.

Meritat organizative drejtuese dhe menaxheriale me 5 komponentë, që përfshijnë:

- cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin (8 pikë);
- aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore (6 pikë);
- aftësitë e komunikimit (6 pikë);
- aftësitë e të punuarit në grup dhe në mjedise multidisiplinore ose multikulturore (6 pikë);
- aftësitë e përfaqësimit në publik (6 pikë).

Totali i pikëve për këtë komponent është 32 pikë.

Merita të tjera: 3 komponentë, që përfshijnë:

- mbajtja e titujve akademikë (8 pikë);
- kryerja e studimeve dhe trajnimeve afatgjata jashtë vendit (8 pikë);
- njohja e gjuhëve të huaja (6 pikë).

Totali i pikëve për këtë komponent është 22 pikë.

Totali përfundimtar për katër kategoritë e meritave që parashikon neni 34 i ligjit, është 100 pikë.

Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimeve të vazhdueshme me përfaqësues të organizmave ndërkombëtare (të cilët kanë qenë pjesë e rëndësishme e implementimit të reformës në drejtësi), në përputhje me përcaktimet e nenit 147, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 6 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016, për vlerësimin e kriterit moral ka kërkuar nga kandidatët plotësimin dhe paraqitjen e deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës. Sekretari i Përgjithshëm ka informuar kandidatët se gatishmëria në plotësimin e kësaj deklaratë vlerësohet me 5 pikë mbi totalin e vlerësimit të kandidatëve me 100 pikë. Mosparaqitja e këtij formulari nuk përbën kusht për skualifikim.

Konkluzionet e Sekretarit të Përgjithshëm

Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit tërësor të dosjeve individuale të kandidatëve, në procesin dhe praktikën e Komisionit Ad Hoc, si dhe në raportin e vlerësimit të tij, duke marrë në konsideratë:

1. dokumentacionin individual të çdo kandidati, dokumentacionin plotësues dhe korrespondencën përkatëse;
2. mjetet procedurale në dispozicion të Komisionit Ad Hoc, për të vlerësuar përmbushjen e kriterëve morale dhe profesionale nga kandidatët, intervistat me kandidatët si dhe përbërjen e Komisionit Ad Hoc (neni 23 i ligjit);
3. parashikimet e nenit 35 të ligjit, i cili i jep të drejtën Sekretarit të Përgjithshëm të kërkojë vetëm plotësimin e dokumentacionit që vërteton plotësimin e kushteve kushtetuese dhe ligjore pa zhvilluar seanca dëgjimore me kandidatët;
4. parashikimet e nenit 35, pika 6, që referojnë në nenin 34 të ligjit, për sa u takon kriterëve profesionale dhe morale të kandidatëve dhe vendimin nr. 4, datë 12.04.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidateve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga radhët e avokatëve”,

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në zbatim të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35, pika 7, të ligjit nr. 115/2016, jep një vlerësim të tij të pavarur nga ai i kryer nga Komisioni Ad Hoc, por duke u mbështetur në procesin e zhvilluar dhe në raportin e përgatitur nga Komisioni.

Për meritat profesionale dhe meritat e tjera bazuar në komponentët përkatës që përcakton neni 34 i ligjit, Sekretari i Përgjithshëm ka kryer vlerësimin e tij bazuar në dokumentacionin provues të dosjeve të çdo kandidati, duke qenë se plotësimi i këtyre meritave ishte i matshëm.

Gjithashtu, për dy nënkomponentët: a) cilësinë e platformës dhe vizionit që paraqet kandidati si dhe d) për aftësitë e përfaqësimit në publik (pjesë të kategorisë së meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale), Sekretari i Përgjithshëm ka kryer vlerësimin e tij bazuar në dokumentacionin e dosjeve të çdo kandidati, duke qenë se ky vlerësim meritash ishte i matshëm.

Nënkomponentët e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, si dhe meritave morale, të përcaktuar në nenin 34, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 115/2016, janë të vështirë për t'u vlerësuar në bazë të dokumentacionit të paraqitur. Në këto kushte, Sekretari i Përgjithshëm, duke pasur në konsideratë përbërjen e Komisionit Ad Hoc, me përfaqësues: Avokatin e Popullit, Kryetarin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, 2 avokatë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe një anëtar të rregullt të Akademisë së Shkencave nga shkencat shoqërore, gjykoi që këto vlerësime të qëndrojnë të pandryshuara, bazuar në faktin që ligjvënësi ka vlerësuar se përbërja e Komisionit Ad Hoc përfaqëson më së miri grupin e interesit (konkretisht, përfaqësinë e avokatëve).

Gjithsesi, Komisioni Ad Hoc mbetet organi përzgjedhës, që ligji i mundëson të gjitha instrumentet e nevojshme për të përcjellë informacion për çdo kandidat, në funksion të procesit përzgjedhës, sipas ligjit nr. 115/2016, duke përbërë një vlerë të shtuar në garancitë që ofrohen për të pasur një proces real të përzgjedhjes.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në respektim të parashikimeve të nenit 147, pika 5, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 34 të ligjit nr.115/2016, vlerëson:

1. Kandidatja Eris Hysi

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidatja ka përfunduar me rezultate të larta ciklin 4-vjeçar të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Kandidatja ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master, gjithashtu, në Universitetin e Tiranës, me rezultate të larta dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në Universitetin e La Sapienza-s në Romë.

Kandidatja në platformën e saj ka parashtruar vizion të qartë për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtare e mundshme dhe objektivat që synon të arrijë KLGJ-ja.

Referuar vërtetimeve të paraqitura, rezulton se kandidatja është e angazhuar dhe si pedagoge e jashtme në universitet.

Kandidatja ka qenë e angazhuar si eksperte ligjore në seminare të ndryshme. Gjithashtu, është pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore, si dhe ka kryer disa publikime.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidatja vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidatja vlerësohet me 20 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidatja vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidatja vlerësohet me 96.6 pikë.

2. Kandidati Erind Mërkuri

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar me rezultate të larta ciklin 4-vjeçar të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës. Kandidati ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master, gjithashtu, në Universitetin e Tiranës, me rezultate të larta dhe ka fituar titullin “Docent” dhe gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.

Kandidati është pedagog i brendshëm në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Drejtësisë. Platforma personale është një dokument i strukturuar mirë, nëpërmjet të cilit kandidati ka paraqitur një panoramë të qartë të rolit që duhet të luajë KLGJ-ja, si dhe ka pasqyruar objektivat që synon në arrijë në rast anëtarësimi të mundshëm në këtë organ.

Referuar CV-së së tij, rezulton se kandidati është angazhuar vazhdimisht si ekspert ligjor.

Kandidati është pjesëmarrës në një numër të lartë konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka një eksperiencë shumë të gjatë dhe të pasur të publikimeve të artikujve shkencorë.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 19 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 19 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 96.3 pikë.

3. Kandidati Erind Gërmenji

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Kandidati, gjithashtu, ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master pranë Universitetit Justiniani I.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 15 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 90.6 pikë.

4. Kandidati Albens Tabaku

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Kandidati, gjithashtu, ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master pranë Universitetit European të Tiranës.

Kandidati ka qenë i angazhuar si ekspert ligjor në disa kompani tregtare, si dhe si pedagog i jashtëm dhe i brendshëm në universitet.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me pikë 15 nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 80.6 pikë.

5. Kandidati Klodian Gjermeni

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar studimet e larta në Alma Mater, Universiteti i Bolonjës, në degën Drejtësi.

Kandidati ka qenë i angazhuar si ekspert ligjor.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 15 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 79.4 pikë.

6. Kandidati Artan Reçi

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë, në universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Kandidati, gjithashtu, ka kryer studimet pasuniversitare të ciklit të dytë master pranë universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Ka publikuar artikujt shkencorë, si dhe është kualifikuar më pjesëmarrje në disa trajnime dhe konferenca.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 14 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 78.8 pikë.

7. Kandidati Bledar Bajri

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës. Gjithashtu, ka përfunduar edhe studimet e larta për Shkenca Politike, në Fakultetin e Shkencave Sociale.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 15 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 76.2 pikë.

8. Kandidati Saimir Kola

Për sa i takon nivelit të studimeve akademike rezulton se kandidati ka përfunduar ciklin 4-vjeçar të studimeve të larta në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës.

Platforma personale tregon një ide të përgjithshme të kandidatit për detyrat dhe rolin që do të luajë si anëtar i mundshëm i KLGJ-së.

Sekretari i Përgjithshëm vlerëson:

- Për meritat profesionale kandidati vlerësohet me 20 pikë nga 24 pikë maksimumi.
- Për meritat e tjera (komponenti për mbajtjen e titujve akademikë) kandidati vlerësohet me 10 pikë nga 22 pikë maksimumi.
- Për dorëzimin e deklaratës së interesave privatë, në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, kandidati vlerësohet me 5 pikë (ekstra).

Në total kandidati vlerësohet me 56 pikë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në:

- argumentimin e mësipërm;
 - vendimin nr. 4, datë 12.04.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, për pikëzimin e kriterëve;
 - vlerësimin e detajuar me pikë të përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga kandidatët, të kryer nga Komisioni Ad Hoc;
 - nenin 35, pika 7, germa “c”, sipas të cilit Sekretari i Përgjithshëm vlerëson shkallën e përmbushjes së kriterëve profesionale dhe morale nga secili kandidat;
 - dokumentacionin e dosjeve individuale të kandidatëve,
- konkludon se renditja e kandidatëve sipas shkallës së plotësimit të kriterëve, siç është paraqitur në tabelën më lart, rezulton:

Nr.	Kandidati	Vlerësimi total
1.	Eris Hysi	96.6
2.	Erind Mërkuri	96.3
3.	Erind Gërmenji	90.6
4.	Albens Tabaku	80.6
5.	Klodian Gjermani	79.4
6.	Artan Reçi	78.8
7.	Bledar Bajri	76.2
8	Saimir Kola	56

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 9 të nenit 35 të ligjit nr.115/2016, i dërgon komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda ditës së nesërme nga dita e hartimit:

- një listë me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- një listë me emrat e kandidatëve, të cilët, sipas vlerësimit të tij, nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ky ligj për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (lista e kandidatëve të përjashtuar përmban emrat e tyre dhe arsyet e përjashtimit për secilin);
- një raport me shkrim, ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat, mbështetur në procesin e zhvilluar dhe në raportin e përgatitur nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc.

Në zbatim të përcaktimit ligjor të nenit 35, pika 9, të ligjit nr.115/2016, listat dhe raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit do të bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Kuvendit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Genci GJONÇA



Aneks 1

Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Avokati i Popullit, me shkresën nr. 294 prot., datë 24.01.2024, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, të ngritur për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Shqipërisë listën e 13 kandidatëve që përmbushin kriteret ligjore, sipas vlerësimit të Komisionit, dhe që kanë marrë pikët më të larta, si dhe listën e 15 kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe raportin e vlerësimit të kandidatëve.

Në protokollin e Kuvendit të Shqipërisë, me kërkesën nr.312, datë 25.01.2024, si dhe nr. 312/1 prot., datë 30.01.2024, z. Saimir Kola ka paraqitur sqarime rreth kërkesëpadisë së depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe vendimin nr.6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Sipas vendimit gjyqësor të depozituar sqarohet se:

Pas njohjes me vendimin nr. 36, datë 29.12.2023, të Komisionit Ad Hoc, z. Saimir Kola ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar:

- konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, vendim i palës së paditur “Për përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak të kandidatit Saimir Kola, për pozicionet vakante: anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, nr. 36, datë 29.12.2023, “Për përjashtimin e paditësit nga konkurrimi”;
- detyrimin e palës së paditur që të shtojë emrin e paditësit në listën e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve;
- detyrimin e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad-Hoc, që t’i përcjellë emrin e paditësit Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

Me vendimin nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur:

- pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së palës paditëse Saimir Kola;
- konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 36, datë 29.12.2023, të palës së paditur Komisioni i Pavarur Ad Hoc “Për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve nga radhët e avokatisë, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë”, pranë Avokatit të Popullit.

Sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 130, pika 2, të ligjit nr. 115/2016: “Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.”

Gjykata e ka trajtuar në tërësi në mënyrë të detajuar çështjen dhe, në përmbyllje të pjesës arsyetuese, Gjykata ka vlerësuar se (citojmë):

“Pala e paditur ka nisur një procedure të re të vlerësimit të paditësit, për shkak të vendimit gjyqësor, duke mos përmbushur detyrimin e saj kushtetues dhe ligjor për të pritur komunikimin e vendimit gjyqësor të arsyetuar dhe për të marrë masat e nevojshme për ta ekzekutuar atë ashtu siç gjykata e ka vlerësuar dhe gjykuar, pra të korrigjonte shkeljet e rënda procedurale të konstatuara prej saj. Pala e paditur ka kryer të njëjtën procedure vlerësimi, të njëjtën shkelje të rëndë procedurale të konstatuar me vendim gjyqësor përfundimtar duke e shtrirë hetimin për një periudhë në tejkalim

të kufijve të ligjit 115/2016, me pasoja skualifikimin e paditësit për herën e dytë radhazi për të njëjtin shkak.

Në analizë përfundimtare, për sa u arsyetua më lart në këtë vendim Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi nr. 36, datë 29.12.2023, i Komisionit të Pavarur Ad Hoc “Për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve nga radhët e avokatisë, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë” pranë Avokatit të Popullit është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të përcaktimit që jep neni 108 i Kodit të Procedurës Administrative, pasi vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me vendim gjyqësor me fuqi detyruese e që ka forcën e ligjit sipas nenit 451/a të KPC, lidhur me procedurën e nxjerrjes së tij.”

Pasi Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë u njoh me vendimin e Gjykatës, vuri në dijeni Avokaten e Popullit se, në protokollin e Kuvendit të Shqipërisë, me kërkesën nr. 312/1 prot., datë 30.01.2024, z. Saimir Kola ka depozituar vendimin nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit. Nisur nga fakti që Sekretari i Përgjithshëm kishte filluar procedurat për verifikimin e plotësimit të kushteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji për kandidaturat e përcjella nga Komisioni Ad Hoc, ka kërkuar trajtimin e këtij rasti dhe informimin sa më parë të Kuvendit.

Në përgjigje të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm, Kryetarja e Komisionit Ad Hoc ka sqaruar se, me përfundimin e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale, me caktimin e peshës specifike të tyre (pikëzimin), si dhe me dërgimin e dokumentacionit pranë Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i Pavarur Ad Hoc e ka përfunduar angazhimin e tij në këtë proces dhe nuk ka më kompetencë lëndore të kryejë asnjë trajtim të mëtejshëm të rastit në fjalë. Lidhur me vendimin gjyqësor të cituar, Avokatja është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit e ka cilësuar vendimin e saj në nivel deklarativ dhe, si i tillë, nuk përmban asnjë detyrim për palën e paditur Avokati i Popullit dhe/ose Komisioni i Pavarur Ad Hoc, për sa kohë që nuk është urdhëruar për asnjë prej këtyre palëve kryerja ose moskryerja e një veprimi apo procedure të caktuar administrative në lidhje me paditësin Saimir Kola, ndonëse e kërkuar prej tij.

Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm ka vijuar me verifikimin e plotësimit të kushteve për kandidaturat e përcjella nga Komisioni Ad Hoc.

Me shkresën nr. 294/3 prot., datë 02.05.2024, Avokati i Popullit, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Ad Hoc, ka përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë raportin shtesë të vlerësimit dhe dokumentacionit përkatës të kandidatit Saimir Kola për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, në zbatim të vendimit nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në pikat 1 dhe 7 të nenit 9, të “Rregullores për funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve”.

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas depozitimit dokumentacionit për vlerësimin e kandidatit nga Avokatia për anëtar të KLGJ-së, ka filluar menjëherë punën për verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore nga kandidati, bazuar në parashikimet e Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.